



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:140883
Datë: 25.08.2023
Numri i dokumentit: 04615605

Ac.nr.10211/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Besnik Bislimaj- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, S. H. nga Gj., të cilën me autorizim e përfaqëson F. S. avokat nga Gj., ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit-Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi me autorizim Burim Maliqi, me objekt kontesti kompensim i pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,848.30 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2061/20, të datës 25.10.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur më **24.08.2023**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit-Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare. **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2061/20, të datës 25.10.2021 dhe **gjykohet** si në vijim: - **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditëses Sebehate Hasani nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar “që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses t’ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 30 vite përvojë pune në institucione shëndetëore, dy paga mujore në shumën në lartësi prej 1.848.30 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 22.10.2020 e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t’ia kompensojë shpenzimet procedurës kontestimore”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2061/20, të datës 25.10.2021 ka gjykuar si në vijim:

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses S. H. nga Gj.e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses S. H. nga Gj. t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 30 vite përvojë pune në institucione shëndetëore, dy paga mujore shumë në lartësi prej 1.848.30 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 22.10.2020 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

II. OBLIGOHET e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë shumë në lartësi prej 269€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë Aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë apo çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pala paditëse ka ushtruar përgjigje ndaj ankesës së të paditurës me propozim që ankesa të refuzohet në tërësi si e papabuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195, par.1, pika e), në lidhje me nenin 201, pika d) të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës, Komuna e Gjilanit- Qendra Kryesore e Mjeksisë Familjare është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 22.10.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e shpërblimit jubilar, ndërsa në seancën gjyqësore të mbajtur me datën 25.10.2021 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që ka kërkuar që të detyrohet e paditura, Komuna e Gjilanit që paditëses t'ia paguaj në emër të shpërblimit jubilar për mbi 30 vite përvojë pune në institucione shëndetëore, dy paga mujore shumë në lartësi prej 1.848.30 euro (924,15x2), me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 22.10.2020 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjegjje të datës 27.01.2021 e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se paditësja e ka bazuar padinë në Kontratën Kolektive Sektoriale, në nenin 17, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2, kurse kjo nuk krijon të drejta dhe detyrime për të paditurën Komuna e Gjilanit pasi që Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti i datës 06.05.2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë dhe se çdo marrëveshje që parasheh

të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik, ndërsa nuk kemi ndonjë udhëzim administrativ të Qeverisë së Kosovës apo Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë autoriteti tjetër publik që precizon dhe rregullon ndonjë të drejtë sipas kërkesëpadisë së palës paditëse.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: Kontratën e punës në kohë të pacaktuar me numër 04-1724 të datës 29.12.2016, Vërtetimin e lëshuar nga QKMF Dr. Nagip Rexhepi nga Gjilani, Pasqyrën bankare në emrin e paditëses, Listën e pagave me numër EM00039027 në emër të paditëses ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se mes palëve ndërgjygjëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është e punësuar tek e paditura, pasi që kjo vërtetohet edhe me kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër 04-1724 të datës 29.12.2016 e lidhur në mes paditëses në pozitën shefe në shërbimin laboratorik dhe të paditurës. Nuk ishte kontestues as fakti se paditësja ka krijuar marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 23.01.1986 e tutje vërtetimit të lëshuar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare Dr. “NagiP Rexhepi”, sipas Listës së pagave me numër EM 00039027 gjykata vërtetoi faktin se paditësja realizon të ardhura mujore nga paga neto prej 2,009.72 euro, dhe se e njëjta ka 34 vite përvojë pune dhe se e ka realizuar një pagë në emër të shpërblimit jubilar në lartësi prej 924.15 euro. Në mes të palëve ndërgjygjëse kontestues ishte baza juridike e kërkesëpadisë, konkretisht fakti nëse e paditura obligohet t’ia kompensoi shpërblimin jubilar paditëses. Në fund gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e mbështetur vendimin e saj në dispozitat e nenit 17, paragrafi 3 dhe 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale, nenit 245 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr 04/L-077. Për kamatën ligjore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452 paragrafi 1 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për këtë gjë u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përkitazi me kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin e shpërblimit jubilar Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*.

Po ashtu me nenin 17 paragrafi 3, të Kontratës Kolektive Sektoriale, e cila ka hyrë në fuqi me datën 11.06.2018, përcaktohet se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: 3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit në vlerë të tri paga mujore të tij”*. Me nenin 17 paragrafi 4 të kësaj Marrëveshje përcaktohet se: *“Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë”*. *Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye se: Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, edhe pse ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë nga ana e paditëses (Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka hyrë në fuqi më datë 12.06.2018) dhe e njëjta edhe pse është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 të Ligjit të Punës, në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pabazuar, për faktin se në këtë rast paditëses nuk i takojnë benefitet nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, duke marrë parasysh faktin se kontrata nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësja ka arritur vitin jubilar për 30 vjet përvojë pune. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka konstatuar që kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Po ashtu, sipas vlerësimit të gjykatës së Apelit në kohën kur paditësja ka arritur vitin jubilar ka qenë në fuqi kontrata e Përgjithshme Kolektive, mirëpo paditësja nuk mund të përfitojë beneficionet as sipas kësaj kontrate, për shkak se nuk e ka bërë kërkesën brenda afatit prej 3 vitesh, pasi që nga koha që paditësi i ka mbushur 30 vite përvojë pune e deri sa është bërë padia kanë kaluar mbi 4 vite, kërkesa është parashkruar dhe prapësimin e parashkrimit e ka paraqitur i padituri me rastin e dhënies së përgjigjes në padi. Në përgjigjen në padi të dorëzuar në gjykatë me datën 27.01.2021, e paditura është thirrur në tejkalimin të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkesë nga ana e paditëses (parashkrim).

Gjykata e Apelit duke e vlerësuar pretendimin e të paditurës për parashkrim, gjen se në këtë çështje juridike kontestuese kërkesa është parashkruar për çka vendosi që ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë. Në këtë rast Gjykata e Apelit i është referuar dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212 me të cilën përcaktohet afati i parashkrimit për kërkesat

nga marrëdhënia e punës, me të cilën dispozitë në mënyrë specifike përcaktohet se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Në rastin konkret paditësja ka arritur përvojën e punës së pandërprerë në kohën kur ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ku është paraparë e drejta për paga jubilarë e cila ka hyrë në fuqi më 01.01.2015, që do të thotë se paditëses i është krijuar kjo e drejtë nga data 01.01.2015, ndërsa padinë për kompensimin e pagave jubilarë në gjykatë e ka ushtruar me datën 22.10.2020, që rezulton se nga koha kur paditësja ka arritur të drejtën për paga jubilarë dhe kur i është krijuar kjo e drejtë, e deri me datën e paraqitjes së padisë në gjykatë kanë kaluar mbi 3 (tre) vite.

Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, andaj vendosi që aktgjykimin ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadisë.

Në kuptim të lartcekurave kjo gjykatë ka vendosur që ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës kjo gjykatë e ka bazuar në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e lartcekura, Gjkata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika e), lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10211/21 , datë 24.08.2023

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka